



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.____.2025

Shtojca 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Data 23.01.2025

Drejtuar: Operatorit ekonomik “BAMI HOLDING” SHPK, me numër NIPTI J94416206R,
Adresa: Durres Fushe Kruje FUSHE KRUIJE Rruga Kamas.

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-26081-10-23-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Asfaltim rruga stacioni trenit – perimore Mamurras, Bashkia Kurbin”.

Fondi limit: 12,083,333 (dymbëdhjetë milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 2 muaj.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: 14.01.2025.

Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Nr.3, datë 20.01.2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **“COMPANY RIVIERA 2008” SHPK**, me numër NIPTI **K81716011V**.
Vlera e ofertuar: 7,791,003 (shtatë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e tre) lekë **pa TVSH**.
2. Operatori ekonomik **“KOMBEAS” SHA**, me numër NIPTI **K88103301J**.
Vlera e ofertuar: 7,883,020 (shtatë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e njëzet) lekë **pa TVSH**.
3. Operatori ekonomik **“RSM COMPANY” SHPK**, me numër NIPTI **810802422**.
Vlera e ofertuar: 8,521,350 (tetë milion e pesëqind e njëzet e një mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë **pa TVSH**.
4. Operatori ekonomik **“BAMI HOLDING” SHPK**, me numër NIPTI **J94416206R**.
Vlera e ofertuar: 10,038,700 (dhjetë milion e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind) lekë **pa TVSH**.
5. Operatori ekonomik **“SARK” SHPK**, me numër NIPTI **K52531415H**.
Vlera e ofertuar: 10,102,138 (dhjetë milion e njëqind e dy mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë **pa TVSH**.
6. Operatori ekonomik **“2 N” SHPK**, me numër NIPTI **L31615017L**.
Vlera e ofertuar: 10,120,098 (dhjetë milion e njëqind e njëzet mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë **pa TVSH**.
7. Operatori ekonomik **“Caushi M” SHPK**, me numër NIPTI **L88419801O**.
Vlera e ofertuar: 10,402,690 (dhjetë milion e katërqind e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë **pa TVSH**.
8. Operatori ekonomik **“ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK**, me numër NIPTI **K82230002K**.
Vlera e ofertuar: 11,401,240 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e një mijë e dyqind e dyzet) lekë **pa TVSH**.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik **“COMPANY RIVIERA 2008” SHPK**, me numër NIPTI **K81716011V**.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

*Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha***

kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE skualifikohet për ofertë anomalisht të ulët për sa më poshtë:

KVO pasi verifikoi dokumentacionin në SPE, konstatoi se oferta të vlefshme të cilat plotësojnë kërkesat për kualifikim, të përcaktuara nga AK në DST janë 7 oferta, (për të cilat mbajti procesverbal për ti verifikuar nëse janë oferta anomalisht të ulëta), konkretisht si vijon:

Operatori ekonomik

Oferta e operatorit ekonomik pa TVSH

- OE “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK	7,791,003
- OE “KOMBEAS” SHA	7,883,020
- OE “BAMI HOLDING” SHPK	10,038,700
- OE “SARK” SHPK	10,102,138
- OE “2 N” SHPK	10,120,098
- OE “Caushi M” SHPK	10,402,690
- OE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK	11,401,240

Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Sipas DST, Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

$$MO = 7,791,003 + 7,883,020 + 10,038,700 + 10,102,138 + 10,120,098 + 10,402,690 + 11,401,240 = 67,738,889 / 7 = 9,676,984.14$$

$$PR = 9,676,984.14 \times 85\% = 8,225,436.52$$

Sipas formulës cdo ofertë e cila është më e ulët se **8,225,436.52** është ofertë me çmim anomalisht të ulët.

Duke qënë se ofertat e operatorëve ekonomikë “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK & “KOMBEAS” SHA janë më të vogla se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme, këto oferta janë me çmim anomalisht të ulët.

Në nenin 82 pika 4 të Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet se:Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve

Gjithashtu edhe në DST, tek Seksioni 1, germa f, pika 22, parashikohet ndër të tjera se:....Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve

Sa më sipër operatori ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK, s’kualifikohen si rezultat i ofertës anomalisht të ulët, bazuar në nenin 82 pika 4 të Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Operatori ekonomik “KOMBEAS” SHA, me numër NIPTI K88103301J.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE skualifikohet për ofertë anomalisht të ulët për sa më poshtë:

KVO pasi verifikoi dokumentacionin në SPE, konstatoi se oferta të vlefshme të cilat plotësojnë kërkesat për kualifikim, të përcaktuara nga AK në DST janë 7 oferta, (për të cilat mbajti procesverbal për ti verifikuar nëse janë oferta anomalisht të ulëta), konkretisht si vijon:

Operatori ekonomik

Oferta e operatorit ekonomik pa TVSH

- OE “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK	7,791,003
- OE “KOMBEAS” SHA	7,883,020

- OE "BAMI HOLDING" SHPK	10,038,700
- OE "SARK" SHPK	10,102,138
- OE "2 N" SHPK	10,120,098
- OE "Caushi M" SHPK	10,402,690
- OE "ERAL CONSTRUCTION COMPANY" SHPK	11,401,240

Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Sipas DST, Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$

$PR = 85 \% Mo$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

$MO = 7,791,003 + 7,883,020 + 10,038,700 + 10,102,138 + 10,120,098 + 10,402,690 + 11,401,240 = 67,738,889 / 7 = 9,676,984.14$

$PR = 9,676,984.14 \times 85\% = 8,225,436.52$

Sipas formulës cdo ofertë e cila është më e ulët se 8,225,436.52 është ofertë me çmim anomalisht të ulët.

Duke qënë se ofertat e operatorëve ekonomikë "COMPANY RIVIERA 2008" SHPK & "KOMBEAS" SHA janë më të vogla se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme, këto oferta janë me çmim anomalisht të ulët.

Në nenin 82 pika 4 të Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet se:Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve

Gjithashtu edhe në DST, tek Seksioni 1, germa f, pika 22, parashikohet ndër të tjera se:Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve

Sa më sipër operatori ekonomik "KOMBEAS" SHA, s'kualifikohet si rezultat i ofertës anomalisht të ulët, bazuar në nenin 82 pika 4 të Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

3. Operatori ekonomik "RSM COMPANY" SHPK, me numër NIPTI 810802422.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....", oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST, (për punë të ngjashme) për sa më poshtë vijon:

Së pari: Operatori ekonomik "RSM COMPANY" SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në DST, pasi nuk ka paraqitur për punë të ngjashme dokumentacionin si më poshtë:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9.
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;

Autoriteti Kontraktor, këto kërkesa i ka përcaktuar në pikën 2.3.1 në DST dhe operatori ekonomik ofertues, është i detyruar që ofertën ta plotësojë sipas kërkesave të AK. Ligji dhe VKM për prokurimin publik si dhe KPP në vendimet e saj thekson se operatori ekonomik pjesmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojë vetëm kërkesat e vendosura nga AK në dokumentat e tenderit, e rrjedhimisht vlerësimi e kualifikimi i tyre bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nëse OE do të kishte pretendime në lidhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga AK në DST, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës ose të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë AK, lidhur me kërkesat e përcaktuara nga AK në DST. KPP si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, në vendimet e saj thekson se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Së dyti: Gjithashtu sqarojmë se puna e ngjashme që OE ka paraqitur nuk është bindëse, pasi referuar dokumentacionit që ky OE ka ngarkuar në SPE (References leshuar nga Ministria e Infrastrukturës si dhe Kontratës datë 28.09.2016) rezulton se:

- Në kontratën datë 28.09.2016, afati i punimeve është 113 ditë.
- Punimet kanë filluar me datë 2.11.2016 dhe kanë përfunduar me datë 3.06.2020 (që i bie që kanë zgjatur rreth 4 vite).

Po ashtu Komisioni i ngritur nga Ministria e Infrastrukturës për pranimin teknik të punës, në procesverbalin e mbajtur në pikën 4.1 të tij ndër të tjera shprehet:**duhet theksuar se gjatë realizimit të punimeve ka pas ndërprerje të shpeshta të punimeve shkak i mos seriozitetit të kompanisë punëkryese** Në bazë të verifikimit të Ditarit Ndërtimor del se

janë (350) ditë pune, çka do të thotë se operatori ekonomik ka tejkaluar dinamikën e paraparë më kontratë (sipas planit dinamik 113 ditë).

Sa më sipër puna e ngjashme e paraqitur nga OE, edhe pse nuk ka dokumentacioni sipas kërkesave të përcaktuara nga AK në DST, gjithashtu nuk është bindëse dhe nuk garanton Autoritetin Kontraktor se ky OE e kryen punën brenda afateve dhe me cilësi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“BAMI HOLDING” SHPK**, me adresë: Durrës Fushe Kruje FUSHE KRUIJE Rruga Kameras, se oferta e paraqitur me vlerë të përgjithshme prej: **10,038,700** (dhjetë milion e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind) lekë **pa TVSH**, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kurbin, adresa: Lagjia Nr.3, Laç (në zyrën e protokollit të Bashkisë Kurbin), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të vepohet, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit:

JO (Nuk ka patur)

Titullari i Autoritetit Kontraktor
Majlinda CARA